



OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____ . _____ . 2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR (PARAPRAK)

Data: 23.09.2024

Drejtuar: “SERDADO” sh.p.k. me NIPT J67902524E

Adresa: Shëngjin, Banese 1 -katëshe, Superstrada Lezhë-Tiranë, km 2, 1401 Lezhë

Procedura e prokurimit/lotit: “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.

Numri i referencës së procedurës /Lotit: REF-17341-08-28-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Riparim dhe mirëmbajtje e mjeteve të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Kurbin”, me fond limit të marrëveshjes kuadër: 3,329,266.67 (tre milion e tre qind e njëzet e nëntë mijë e dy qind e gjashtë dhjetë e gjashtë pikë gjashtë dhjetë e shtatë) Lekë pa TVSH, me afat të marrëveshjes kuadër 24 (njëzet e katër) muaj.

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike: NR. 56 Datë 02.09.2024.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “SERDADO” sh.p.k. me NIPT J67902524E

Vlera e ofruar: 3,173,600 (*tremilion e njëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e gjashtë qind*) lekë pa TVSH

2. Operatori ekonomik “Auto Manoku Servis” sh.p.k. me NIPT L62311016C

Vlera e ofruar: 2,496,950 (*dymilion e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e nëntë qind e pesëdhjetë*) lekë pa TVSH

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

Operatori ekonomik “Auto Manoku Servis” sh.p.k. me NIPT L62311016C

Përkatësisht për arsyet si më poshtë:

OE nuk plotëson pikën 2.3.3 të seksionit 2.3 Kapaciteti Teknik të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit, pasi për punonjësit e mëposhtëm ka paraqitur:

a) Për profilin e kërkuar “Motorist”, ka paraqitur kontratë pune me punonjësin Florenc Gurabardhi të shoqëruar me Dëshmi Kualifikimi nga H.V.A.T organizëm Certifikimi dhe Çertifikatë Trajnimi nga subjekti “VELMAR” sh.p.k;

b) Për profilin e kërkuar “Elektroauto” kontratë pune me punonjësin Ani Semini të shoqëruar me Dëshmi kualifikimi nga H.V.A.T organizëm Certifikimi.

Certifikatat e mësipërme nuk plotësojnë kërkesën për kualifikim të vendosur nga AK e cila kërkon Dëshmi e aftësisë profesionale, sipas Ligjit Nr.15/2017, “Mbi arsimin dhe formimin profesional”, i ndryshuar.

Për sa më lart OE skualifikohet për mosparaqitje të dokumtacionit të plotë dhe të saktë.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik “SERDADO” sh.p.k. me NIPT J67902524E, me adresë: *Shëngjin, Banese 1 -katëshe, Superstrada Lezhë-Tiranë, km 2, 1401 Lezhë*, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 3,173,600 (*tremilion e njëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e gjashtë qind*) lekë pa TVSH, është identifikuar si fitues (paraprak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

TITULLARI I OPERATORIT TË BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA